

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 2394 Prishtinë, Dt. 17.07.2024

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	Fakulteti i Shkencave Matematike dhe Natyrore
Departamenti/ Programi	Biologji
Projektpropozimi	Vlerësimi i përbërjes kimike dhe aktivitetit antioksidativ të llojet <i>Salvia sclarea</i> , <i>S. verticillata</i> dhe <i>S. nemorosa</i> nga popullatat natyrore në Kosovë
Kandidati	Albina Ahmeti Halili
Mentori	Prof. Dr. Avni Hajdari
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 26.12.2023
	Vendimi nr.: 7910
Vlerësimi i dorëshkrimit	<p>Tema e master-it "Vlerësimi i përbërjes kimike dhe aktivitetit antioksidativ të llojet <i>Salvia sclarea</i>, <i>S. verticillata</i> dhe <i>S. nemorosa</i> nga popullatat natyrore në Kosovë" e kandidatës Albina Ahmeti Halili është punuar në Departamentin e Biologjisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, përkatësisht në laboratorin e Ekologjisë së Bimëve. Tema është realizuar sipas procedurave dhe dinamikës së paraparë në programin e punës të paraqitur së bashku me kërkesën për vlerësimin të projekt-propozimit të temës.</p> <p>Dorëshkrimi është shkruar në 42 faqe, me rrallor 1.5 ku janë përfshirë këta kapituj: Abstrakti, Abstract (në gjuhën Angleze), Hyrja, Materiali dhe metodat e punës, Rezultatet dhe diskutimi, Përfundimi, Literatura dhe Biografia. Në punim janë prezantuar 6 figura dhe 2 tabela. Kandidatja gjatë shkruarjes së dorëshkrimit ka shfrytëzuar literaturë të mjaftueshme duke cituar 91 artikuj shkencor dhe burime tjera të literaturës.</p> <p>Në kapitullin Hyrje, kandidatja ka përshkruar rëndësinë e këtij hulumtimi, biologjinë e llojeve <i>Salvia sclarea</i>, <i>S. verticillata</i> dhe <i>S. nemorosa</i>, emërtimet, përdorimin etnobotanik, përbërjen kimike, si dhe efektet farmakologjike dhe toksikologjike të llojeve të përzgjedhura për këtë studim. Po ashtu, kandidatja ka adresuar qartë qëllimin e këtij hulumtimi.</p>

Në kapitullin **Materiali dhe metodat**, kandidatja ka përshkruar në detaje dizajnin e punës eksperimentale, mënyrën e mbledhjes së materialit bimor, ekstraktimit të substancave bioaktive nga materiali bimor, mënyrën e analizimit të komponimeve kimike të marra për studim, si dhe metodat statistikore të përdorura për analizimin e rezultateve.

Në kapitulli **Rezultatet dhe diskutimi**, kandidatja ka përfshirë dhe shqyrtuar rezultatet e gjetura për përbërjen kimike të vajrave esenciale, sasinë e fenolëve totale, flavonoideve totale dhe aktivitetin antioksidativ të tri llojeve të gjinisë *Salvia*. Materiali bimor është grumbulluar në Novobërd. Për secilin parametër të analizuar ka dhënë mesataren dhe devijimi standard (në tabelat përkatëse). Po ashtu kandidatja për të adresuar dallimet fitokimik ndërmjet llojeve të analizuara, kandidatja ka aplikuar analizën e variancës (ANOVA). Për më shumë ajo ka vlerësuar edhe ndikimin e sasisë së fenolëve totale, flavonoideve totale në aktivitetin antioksidativ duke përdorë analizën e korrelacionit. Gjetjet e veta kandidatja i ka krahasuar me ato të autorëve të tjerë.




Në kapitullin **Përfundimi**, kandidatja ka dhënë një përmbledhje të gjetjeve kryesore të këtij hulumtimi. Në bazë të rezultateve të fituara kandidatja konstaton se në përgjithësi përbërja kimike të vajrave esenciale, sasia e fenolëve totale, flavonoideve totale dhe aktivitetit antioksidativ ndërmjet llojeve *Salvia sclarea*, *S. verticillata*, *S. nemorosa* ishte e ndryshme. Po ashtu konstaton që kishte dallime të rëndësishme sa i përket përbërjes kimike të vajrave esenciale, sasisë së fenolëve totale, flavonoideve totale dhe aktivitetit antioksidativ ndërmjet luleve de gjetheve të të njëjti lloj bimor.

Nga ajo që u tha më lartë (bazuar në punën e bërë nga kandidatja) mund të konkludohet se rezultatet e fituara në këtë punim paraqesin kontribut për njohjen e përbërjes kimike dhe variabilitetit të këtyre komponime ndërmjet *Salvia sclarea*, *S. verticillata* dhe *S. nemorosa* nga popullatat natyrore në Kosovë, ndërsa kandidatja ka fituar njohuri për hulumtime në të ardhmen në këtë lëmi.

Këshillit Shkencor-Mësimor të Departamentit të Biologjisë dhe të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore i propozojmë që të aprovoj këtë raport dhe kandidatit Albina Ahmeti Halili ti lejoj mbrojtjen e temës.

Prishtinë, 11.07.2024

Komisioni:

1. 
/ Prof. Dr. Behxhet Mustafa - kryetar /
2. 
/ Prof. Dr. Avni Hajdari - anëtar (mentor) /
3. 
/ Prof. Dr. Avdulla Alija - anëtar /